Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Burim Guri	**16.08.2023**	**26.08.2023**	**2023/0586**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 14.08.2023, OE “. Limit L & B SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0586, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “. Limit L & B SH.P.K.”- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Shtruarja e dyshemese me epoksid dhe ndertimi i kartotekes ne objektin e ri te QKMF-s ne KK Mamushe” me nr. të prokurimit: "626-23-5792-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E MAMUSHËS. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë te hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontrates: punë, furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 32,942.25 €. Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0586 i dt:14.08.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së – Qëllimi

Neni 6 i LPP-së - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca

Neni 56 i LPP-së - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 i LPP-së - Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 69 i LPP-së - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale.

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt. 09.06.2023, kurse data e fundit për dorëzim të tenderëve dhe hapja e ofertave ka qenë me dt. 03.07.2023. Kriter kryesor për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Me dt. 25.07.2023, përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku e ka rekomanduar per kontrate OE EKO TERM SHPK, si dhe na ka eliminuar neve duke e shënuar se tenderi juaj është administrativisht i papërgjegjshëm.

Arsyeja e AK-se për eliminim tonë, tani është si vijon :

Fillimisht ju sqarojmë se arsyet e eliminimit janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara dhe janë në kundërshtim të plotë me faktet dhe dëshmitë e ofruara nga ne. Pretendimet tona ankimore ndaj arsyetimit te AK-sw do ti sqarojmë ne vazhdim:

Sa i përket arsyes së eliminimit se ne kemi ofruar sigurimin e tenderit me vlere prej 1.000,00 eurove per 89 dite, dhe jo per 90 dite siq eshte kërkuar ne dosje te tenderit eshte i pa qëndrueshëm dhe i pa bazuar. Ju sqarojmë se ne kemi ofruar sigurimin e tenderit per 90 dite ashtu siq edhe eshte kërkuar ne kete aktivitet te prokurimit, e siq kërkohet ne shumicën e rasteve. Nëse e analizoni sakt sigurimin e tenderit e shikoni se dt. E fillimit te sigurimit eshte ....dhe mbaron me dt.... qe i bije sakt 90 dite dhe ne përputhje me kërkesën e dosjes se tenderit.

Pra siq e kemi dëshmuar dhe po e saktesojm se arsyeja e AK-sw per eliminim tone eshtee pa bazuar dhe nuk përkon me faktet e ofruara nga ne. Pas qasjes ne dokumentet e OE te rekomanduar per kontrate, kemi vërejtur se AK-ja ka rekomanduar per kontrate nje OE te pa përgjegjshëm e per te cilin do te sqarojmë si me posht: OE i rekomanduar per kontrate nuk e plotëson kërkesën tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1& 9.2 ku kërkesë ka qene:

1. Operatori ekonomik , duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për pune të ngjashme gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, së paku 45,000.00€. dëshmi e kërkuar dokumentare: . Lista e projekteve të realizuara për punë të ngjashme në tri vitet e fundit e cila duhet të përmbajë shërbimet e përfshira; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin e dëshmuar me "Referencë" ose "Raport" për realizimin me sukses të Kontratës. (i) Kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e certifikatës(certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e çdo dokumenti nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i shërbimit të tillë si dhe dëshmia për kryerjen e pagesës(transaksioni bankar fatura etj). OE i rekomanduar per kontrate ka ofruar disa dëshmi per disa projekte te realizuar por qe nuk kan te bëjnë me natyrën e kontratës ose pune te ngjashme. Ne listën e projekteve te realizuar nga OE i rekomanduar per kontrate vërehet se nuk ka përfunduar asnjë projekt me "Shtruarje e dyshemesë me epoksid" dhe kjo e bene te qarte faktin se ky OE nuk ka punuar asnjëherë nje pune te till. Dihet qarte fakti se AK-ja ka

kërkuar saktësisht bazuar edhe ne titullin e kontratës qe punimi kryesor duhet te jete me Epoksid, gjë qe OE i rekomanduar per kontrate nuk e ka ofruar asnjë dëshmi qe ka punuar me ketë material tedyshemesë. Nisur nga ky fakt vërehet qartë dhe dëshmohet se OE i rekomanduar për kontrate nuk e plotësin kërkesën e lartcekur dhe se nuk e përmbush ne tansi kërkesat e FDT-se dhe dosjes se tenderit dhe si i tillë duhet te eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit sepse është OE i pa përgjegjshëm.

Me dt.02.08.2023 kemi pranuar nga AK-ja njoftimin mbi vendimin per refuzimin ekerkeses per rishqyrtim, duke e cilsuar si te pa bazuar. AK-ja refuzimin e kerkeses per rishqyrtim e ka arsyetuar si ne vijim:

Ky arsyetim i AK-sw eshte i pa qwndrushem dhe nuk perkon me faktet reale, por vetem eshte tentim per ta arsyetuar vendim e saj dhe per te na shpallur neve si OE te papergjegjshem. Ju sqarojme se ne kemi ofruar sigurimin e tenderit 90 ditor ashtu siq eshte kerkuar ne dosje te tenderit nga AK-ja dhe se ky fakt vertetohet qarte dhe lehtesisht. Sigurimi i tenderit fillon me daten 03.07.2023 dhe perfundon me dt.30.09.2023, pra nese mblidhen ditet i bije 90 dite te plota.

Nese kalkulohet sakt i bije 29 dit te muajit 7, 31 dit te muajit 8 dhe 30 dit te muajit 9, pra gjithesej 90 dite. Per ne nuk qendron arsyetimi i AK-sw se OE tjeret kan ofruar sigurim tenderi me datat tjera, por AK-ja eshte dashur ta shikoj dhe vlersoj sakt sigurimin tone dhe te na shpall si OE te pergjegjshem. Pra siq dwshmohet eshte i sakt dhe ne perputhje me kerkesat e autoritetit kontraktues sigurimi i tenderit tone, por se ne kete rast AK-ja qellimshem po na diskirminon dhe po na elimnon nga ky aktivitet i prokurimit. AK-ja ne arsyetimint tjeter ka deklaruar se:

Ky arsyetim i AK-sw eshte i pa qendrushem sepse, nese analizohet sakt titulli i kontrates si dhe oferten e OE te rekomanduar per kontrate, OE ka ofertu per epoksid antistatik me cmim 18,762.5 euro ndersa oferta totale eshte 23,961.25, pra punet me eposkid arrijn 78.4 % te oferts totale, ndersa si deshmi qe ka perfundu pune te ngjashem nuk e ka ofruar asnje deshmi. Pra perderisa 78.4 % e ofertes totale dhe puneve qe do te kryehen jane me Epokisd, eshte dashur minimalisht te ofrohen deshmi se OE I rekomanduar per kontrat ka punuar me kete lloj dyshemje ose te ngjashme. Nese analizohet ne tansi deshmit e ofruar nga OE I rekomnadnuar per kontrate jane vetem renovime, izolime te jashme dhe pothuajse asnje pune ne lidhje me shtrim te dyshemes me Epoksid. Ky fakt e deshmon qarte se OE I rekomaduar per kontrate nuk e ploteson kerkesen e lartcekur ne lidhje me ofrimin e deshmive qe ka perfdunu pune te natyres se ngjashme, dhe si I till duhet te shpallet OE I papergjegjshem. Nisur nga deshmir e ofruar nga ne si dhe sqarimeve te cilet I kemi bere ne kerkesn per rishqyrtim si dhe tani ne kete ankese, deshmohet qart se ne jemi OE I pergjsheshme dhe duhet te rekomandohemi per kontrate. Ne konsiderojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në sipas nenit 59 të Ligjit Për Prokurim Publik sepse jemi eliminuar në mënyrë të kundërligjshme dhe duke u diskriminuar në kundërshtim me nenin 7 Ligjit Për Prokurim Publik sepse jemi eliminuar edhe pse i kemi përmbushur të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Gjersa ne jemi ofertues i përgjegjshëm, si dhe nga këto dëshmi konkrete kuptohet se nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që është tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, pra nuk është respektuar edhe një dispozitë e Ligjit Për Prokurim Publik e kjo dispozitë është neni 60 paragrafi 1.1 i këtij Ligji. Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të

fondeve publike, burimeve publike si dhetë gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, ndërsa AK-ja në këtë rast ka vepruar në kundërshtim me këto dispozita ligjore dhe duke e rrezikuar dëmtimin e buxhetit pa ndonjë arsye konkrete, duke na eliminuar neve si ofertues i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët.

Si përfundim kërkojmë nga OSHP që të nxjerr:

V E N D I M

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE "LIMIT L&B" SH.P.K.

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në RIVLERSIM,

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1) Deklarata nën betim se Operatori Ekonomik i plotëson kushtet në bazë të nenit 65 Paragrafi 65.1 pikat 1.1; 1.2; 1.3 të LPP-se.

2) Operatori Ekonomik nuk duhet të jetë në falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësorë pranë ndonjë Gjykate kompetente evendit të themelimit të Operatorit Ekonomik.

3) Operatori ekonomik nuk duhet të jetë delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit.

4) Operatori ekonomik duhet të ketë paguar tatimin në pronë në vendin e themelimit te biznesit së paku deri në periudhën e fundit nga data e publikimit te njoftimit për kontratë.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1) Deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar dhe e vulosur nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2 të dosjes së tenderit.

2) Një vërtetim apo certifikatë origjinale (ose kopje e noterizuar) i lëshuar nga Gjykata kompetente. Vërtetimi kërkohet vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të vendimit për dhënie të kontratës dhe nuk duhet te jete me i vjetër se 180 ditë nga data e lëshimit deri ne datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose ftesës për ofertë.

3) Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik. Vërtetimi kërkohet vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të vendimit për dhënie të kontratës dhe nuk duhet te jete me i vjetër se 90 ditë nga data e lëshimit deri ne datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose ftesës për ofertë.

4) Vërtetimi apo certifikata nga Komuna në tëcilën është themeluar biznesi .Vërtetimi kërkohet vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të vendimit për dhënie të kontratës dhe nuk duhet te jete me i vjetër se 60 ditë nga data e lëshimit deri ne datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose ftesës për ofertë.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

1. Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin përkatës profesional, të bizneseve dhe ose të korporatave.

2. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të jenë deklarues të TVSH-së.

3. Operatorë ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë regjistruar numrin fiskal në ATK.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Kopja e Certifikatës së biznesit së bashku me pjesët informative të biznesit.

2. Kopja e certifikatës së TVSH-së të lëshuar nga Organi Kompetent.

3. Kopja e Certifikatës së regjistrimit të numrit fiskal (nëse nuk është e përfshirë në certifikatën e biznesit).

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1.Operatorët Ekonomik duhet të kenë një qarkullim financiar në tri vitet e fundit së paku 60,000.00 €.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Raportin, raportet apo vërtetimet përkatëse nga një ose më shumë banka ose deklaratat vjetore në ATK apo nga institucioni kompetent në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilat dëshmohet se O.E ka pasur një qarkullim financiar në tri vitet e fundit sipas kërkesës së lartshënuar.

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. Operatori ekonomik , duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për pune të ngjashme gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, së paku 45,000.00€.

2. OE duhet të kenë staf të mjaftueshëm të punëtorëve dhe inxhinierëve të kyçur në projekt, minimumi 5 punëtor të rregullt ose me parakontratë nga të cilët minimumi 2.1 Një inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë ose master, drejtimi konstruktiv, kërkohet të ketë min. 5 vite

përvojë pune pas diplomimit –angazhime profesionale.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Lista e projekteve të realizuara për furnizime të ngjashme në tri vitet e fundit e cila duhet të përmbajë shërbimet e përfshira; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin e dëshmuar me "Referencë" ose "Raport" për realizimin me sukses të Kontratës. (i) Kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) Kur furnizimi është bërë për një blerës privat,për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e çdo dokumenti nënshkruar nga blerësi dheevidentimi i shërbimit të tillë si dhe dëshmia për kryerjen e pagesës(transaksioni bankar fatura etj).

2.1 Listën origjinale të punëtorëve të O.E. të nënshkruar dhe vulosur nga O.E. 2.2. Për inxhinierin e ndërtimtarisë diplomën e noterizuar te noteri. CV-të e përshkruar qartë me eksperiencën e kërkuar të nënshkruar ngainxhinierët (origjinal ose kopje të noterizuar).

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Komisioni vleresues pas ekzaminimit dhe krahasimit te secilit tender veq e veq, konstatoi se OE me nr. rendor 1,3 dhe 4 kane ofruar tender te pergjegjshem ne pershtatje me te gjitha kerkesatne dosje te tenderit dhe njoftimin per kontrate ndersa OE me nr. rendor 2 dhe 5 nuk kane ofruar tender te pergjegjshem. Duke u bazuar ne kriterin per dhenie te kontartes "Tenderi i pergjegjshem me cmim me te lire" komisioni konstatoi se OE Term sh.p.k. ka ofruar tenderin e pergjegjshem me cmim me te ulet ne mesin e tenderuesve te pergjegjshem pjesemarres ne kete tender. Andaj komisioni unanimisht rekomandoi qe ketij operatori ekonomik ti jepet kontarata ne fjale.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **. Limit L & B SH.P.K.**

Sqarim hyres lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:"Shtrurja e dyshemese me epoksid dhe ndertimi i kartotekes ne objektin e ri te QKMF-se ne KK Mamushe", me numer te prokurimit: 626-23-5792-521.

Fillimisht eksperti shqyrtues sqaron se pretendimet ankimore kane te bejne kunder arsyetimit te eliminimit te ofertes se OE ankues, ku AK Komuna Mamushe sipas letres standarte ka potencuar se Sigurimi i Tenderit i prezantuar nuk i ploteson kerkesen kualifikuese, perkatesisht periudhen e kerkuar prej 90 dite.

Pretendimet ankimore;

AK Komuna Mamushe ne dosjen e tenderit tek pika 13.1 dhe 13.2, ka kerkuar si me poshte:

Siguria e tenderit	13.1	A është e nevojshme siguria e tenderit*:* Po J *Nëse kërkohet sigurimi i tenderit:* Tenderuesi duhet të depozitoj sigurimin e tenderit

13.2	Vlera e sigurisë së tenderit **1.000.00** Vlefshmëria e sigurisë së tenderit ne ditë **90** apo muaj

OE ankues ne oferten e tij ka prezantuar Sigurimin e Tenderit me validitet nga Kompania e Sigurimeve Sigal, ne vlere prej 1,000.00 Euro, per periudhen kohore nga data 03.07.2023 deri me date 30.09.2023, sipas dateve te pershkruara rezulton qe e mbulon periudhen kohore te kerkuara prej 90 ditesh, prandaj kete pretendim ankimor e konsiderojme si te bazuar, pasi qe hapja e ofertave eshte bere me daten 03.07.2023, date kjo kur fillon dhe numerohet si garancion per sigurim te tenderit.

Sa i perket pretendimit tjeter ankimor ku Operatori Ekonomik ankues pretendon se OE i rekomanduar per dhenie te kontrates eshte i pa pergjegjshem pasi qe i njejti nuk prezantuar deshmi per proektet e kerkuar nga AK.

Eksperti shqyrtues sqaron se AK Komuna Mamushe ne piken 9.1 dhe 9.2 te Kerkesat e Kapacitetit Teknik dhe Profesional ka kerkuar:

Kapaciteti teknik dhe professional:

1. Operatori ekonomik , duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për pune të ngjashme gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, së paku 45,000.00€.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Lista e projekteve të realizuara për punë të ngjashme në tri vitet e fundit e cila duhet të përmbajë shërbimet e përfshira; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin e dëshmuar me "Referencë" ose "Raport" për realizimin me sukses të Kontratës. (i) Kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e çdo dokumenti nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i shërbimit të tillë si dhe dëshmia për kryerjen e pagesës(transaksioni bankar fatura etj).

Operatori Ekonomik i rekomanduar per dhenie te kontrates sipas ofertes rezulton qe ka prezantuar listen e projekteve se bashku me deshmi tjera dokumentare permes te cilave vertetohet se i njejti e mbulon kerkese kualifikuese.

OE ankues ne ankese potencon se OE i rekomanduar per dhenie te kontrates nuk prezantuar deshmi sipas natyres se kontrates, megjithe ate kerkesa e percaktuar ne dosjen e tenderit dhe ne njoftim per kontrate eshte percaktuese per projekte te ngjashme dhe jo te njejta, ndersa qeshja tjeter lidhur me ata se i njejti nuk posedon furnizim me epoksid, sqarojme se AK Komuna Mamushe nuk ka kerkuar kontrata te furnizimeve te tilla, prandaj kete pretendim ankimor e kualifikojme si te pa bazuar.

Si perfundim eksperti shqyrtues sqaron se sipas precesverbalit te hapjes se ofertave, OE ankues ka ofertuar me cmim me te larte se ai i rekomanduar per dhenie te kontrates, prandaj edhe po te kthehej lenda ne rivlersim, bazuar ne kriterin e dhenies se kontrates (cmimi me i

lire), rezultati mbetet i njejte.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar pjesërisht, ndersa vendimi i AK-së të mbetet në fuqi.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E MAMUSHËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **. Limit L & B SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Burim Guri